

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Insight Time Academy"

Sot në datën 14.05.2024 në Tiranë, pala e mëposhtme:

Z. Genci Xhaçka, lindur më datë 01.05.1967, në Berat, me leternjoftim me nr. Personal G70501128C dhe banues në Rr. "Hajdar Hidi", Ndërtesa 82, Apartamenti 18, Njësia Bashkiake nr. 10, 0000, Tiranë, ka vendosur të hartoje Aktin e Themelimit të mëposhtëm të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Insight Time Academy" (më poshtë "Shoqëria") veprimtaria e së cilës do të rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga Statuti i saj.

Neni 1 – Emri

1.1 Emri i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "Insight Time Academy" (më poshtë "Shoqëria")

Neni 2 – Selia dhe logo

2.1 Selia ligjore e Shoqërisë është Rruga "Pjetër Bogdani", Blloku, Kat 1, Tiranë, Shqipëri.

2.2 Logo e Shoqërisë është:



Neni 3 – Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore 10 vjeçare, 14.05.2024 – 14.05.2034, dhe mund të zgjatet / ndryshojë me vendim të Ortakut të Vetëm / Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4 – Objekti i Veprimitarisë

4.1 Shoqëria ka për objekt veprimitarie aktivitete të orientuara kryesisht drejt:

- Hapjes dhe administrimit të Institucioneve Private Ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional, të llojit "Qëndër Formimi Profesional" si dhe i atyre Arsimore Plotësuese Parauniversitare Private;

A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized form of the name "Genci Xhaçka".

- Aktivitete në fushën e edukimit parashkollore privat;
- Aktivitet mësimdhënie në fushën e arsimit të ciklit të ulët, 9-vjeçar, arsimit të mesëm të profilizuar dhe të përgjithshëm dhe të arsimit të lartë;
- Kurse kualifikimi në gjuhën e huaj Anglisht, Gjermanisht, Italisht etj.;
- Përkhime të literaturove dhe dokumentacioneve të ndryshme.

4.2 Shoqëria mund të kryejë në pjesën tjeter të aktiviteve të saj të gjitha operacionet tregtare, industrial, financiare, bankare, që vlerësohen nga organi administrativ si të nevojshme ose të dobishme ose plotësuese për realizimin e veprimtarisë së saj, si dhe çdo aktivitet tjeter në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të aktiviteve të rezervuara me ligj ose rregullore për subjekte posaçërisht të autorizuara ose që krijojnë karakteristika të veçanta që nuk zotërohen nga Shoqëria.

4.3 Shoqeria (i) mundet të marrë pjesë financiarisht ose operacionalisht edhe në shoqëri të përkohshme sipërmarrjesh, *joint venture*, ose (ii) të zoterojë, të blejë dhe të shesë kuota në subjekte të tjera, shoqëri ose sipërmarrje të tjera edhe në fazën start-up, duke pasur një objekt të ngashëm, plotësues ose në çdo rast të lidhur me të sajin; Shoqëria mund të japë garanci reale dhe/ose personale, pengje, garanci, garanci hipotekore në favor të palëve të treta pa e shndërruar këtë në një aktivitet parësor.

Neni 5 – Kapitali shoqëror, Kontributet dhe Kuotat

5.1 Kapitali shoqëror i Shoqërisë është 100.000 Lekë, ekuivalent në euro me 993.74 Euro bazuar në kursin e sotëm të këmbimit Lekë/Euro: 1 Eur = 100.69 Lekë¹.

5.2 Kapitali shoqëror përbëhet nga 1 (një) kuotë e nënshkruar plotësisht, me vlerë nominale sipas kontributit të Ortakut të Vetëm në kapitalin shoqëror të Shoqërisë, të përcaktuar në nenin vijues 5.3. Pagesa e kapitalit shoqëror duhet të bëhet brenda 120 (njëqind e njëzet) ditëve kalendarike nga data e këtij Akti Themelimi.

5.3 Kontributi i kapitalit themeltar u krye nga Ortaku i Vetëm si më poshtë:

- i. Ortaku i Vetëm, Z. Genci Xhaçka, nënshkruan 1 (një) kuotë në Lekë gjithsej 100.000 Lekë, e barazvlefshme 100% me kapitalin e Shoqërisë, e cila zotërohet 100% nga Ortaku i Vetëm Z. Genci Xhaçka.

¹ Kursi datë 10.05.2024

Neni 6 – Transferimi i kuotave

Kuotat e Shoqërisë do të jenë të transferueshme sipas metodologjive të përcaktuara nga Statuti.

Neni 7 – Administrimi

7.1 Nëpërmjet këtij Akti Themelimi emërohet për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, 1 (një) Administrator i Shoqërisë, si më poshtë:

- **Znj. Alba Shytermeja**, shtetase shqiptare, e lindur më 03.07.1983, në Fier, Shqipëri me letërnjoftim me nr. Personal I35703098A, banuese në Rr. "E Kavajës", Ndërtesa 120, Hyrja 9, Apartamenti 31, Njësia Administrative nr. 7, 1023, Tiranë.

7.2 Administratori përfaqëson Shoqerinë përballë të tretëve, në proceset gjyqësore dhe ushtron të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me parashikimet e këtij Statuti, Ligjt nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar ("Ligji tregtar") dhe vendimet e Asamblesë së Ortakëve.

7.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe detyrimet e nevojshme për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit dhe parashikimeve në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori mund të asistohet nga palë të treta ose konsulente të cilëve mund t'u delegojë një pjesë ose të gjithë ekzekutimin e aktiviteteve të sipërpërmendura.


7.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të Shoqërisë në krijim deri në regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ai është i autorizuar të nënshkruajë të gjitha dokumentet dhe të marrë përsipër në emër të Shoqërisë detyrimet që rrjedhin nga momenti i regjistrimit të tij në vetë Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të delegojë kompetencat e tij edhe tek persona të tjera të ngarkuar posaiçërisht.

Neni 8 - Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM

Z. Genci Xhaçka


(Përfaqësuar me Prokurë nga Av. Ardjana Shehi Kalo)